



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 89 Prot

Tiranë, më 21.01.2022

V E N D I M

Nr.10, datë 21.01.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 672, datë 16.6.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** dhe të aktit nr. 691, datë 30.6.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** , si dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjeve,

Vërej se:

Nëpërmjet dy kërkesave të regjistruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 672 prot., datë 16.6.2021, nga nëpunësi doganor ***** dhe nr. 691 prot., datë 30.6.2021, nga nëpunësi doganor ***** , janë ngritur pretendime se, në kryerjen e transferimeve të përkohshme përkatëse, nuk janë respektuar rregullat e parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe ligji nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për arsye se, në rastin e nëpunësit ***** , brenda 2 viteve janë bërë tre transferime të njëpasnjëshme, në kundërshtim me pikën 1/a, të nenit 48, të ligjit për nëpunësin civil, ndërsa në rastin e nëpunësit ***** , ka kaluar afati 6-mujor i transferimit që përcakton ligji në rastin e transferimit të përkohshëm, prandaj në të dy rastet kërkohet kthimi në vendin e mëparshëm të punës.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe pas analizës së dokumentacionit, konstatohet se, në të dy rastet, kemi të bëjmë me nëpunës civilë, të cilët, pas ristrukturimit të institucionit, janë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, respektivisht, nëpunësi ***** me aktin nr. 1606/6, datë 13.3.2019, në pozicionin “*Specialist, Sektori i Kontrollit A posterior dhe Regjimeve Doganore*”, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë DPD (akti nr. 6509/1, datë 25.3.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për emërimin në pozicionin e mësipërm) dhe nëpunësi ***** , është emëruar me aktin nr. 625/156, datë 7.2.2019, në pozicionin “*Doganier, Terminali i Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenjerët*”, Dega Doganore Durrës (akti nr. 7253, datë 23.3.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave).

Për të gjitha veprimet e kryera, janë mbajtur parasysh rregullat për rastet e ristrukturimit, që parashikon ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozitat e legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, zbatohen edhe dispozitat posaçme të Kodit Doganor.

Pasi kanë marrë emërimet e përhershme në pozicionet si më sipër, rezulton se, për nevoja të institucionit, punonjësit në fjalë, janë transferuar në mënyrë të përkohëshme, si më poshtë:

-Nëpunësi ***** , ka tre akte transferimi të përkohshme të njëpasnjëshme: me aktin nr. 29093, datë 20.11.2019, transferuar përkohësisht në pozicionin “*Përgjegjës Zyre, Terminali i Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenjerët*”, në Degën Doganore Durrës (kat. III-b); me aktin nr. 13134, datë 13.7.2020, transferohet në pozicionin “*Doganier, Sektori Vlerës në Qendër*”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në DPD (kat. III-b) dhe me aktin nr. 10549, datë 11.6.2021, është transferuar përsëri, në mënyrë të përkohëshme, në pozicionin “*Doganier, Sektori Doganor Porto Romano*”, Dega Doganore Durrës (kat. III-b).

Në kërkesën e tij, punonjësi doganor ***** , pretendon se, këto veprime të institucionit në lidhje me transferimin e tij të përkohshëm në tre pozicione, pune brenda dy viteve, pa u kthyer në asnjë rast në pozicionin e mëparshëm, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili parashikon transferimin e përkohshëm, për nevoja të institucionit, në një pozicion pune të së njejtës kategori, deri në 6 muaj, gjatë 2 viteve.

-Nëpunësi *****, ka dy akte transferimi të përkohshme, të njëpasnjëshme: me aktin nr. 3529, datë 19.2.2020, është transferuar përkohësisht në pozicionin “*Doganier, Zyra e Mbikëqyrjes Doganore*”, në Degën Doganore Berat (kat. IV-a); ndërsa me aktin nr. 11507, datë 22.6.2020, transferohet në pozicionin “*Përgjegjës Zyre, Zyra e Operacioneve Doganore*”, në Degën Doganore Berat (kat. III-b). Në kërkesën e tij, punonjësi në fjalë pretendon se tashmë është tejkaluar ndjeshëm afati 6-mujor, që parashikon ligji në rastin e transferimit të përkohshëm.

Në të dy rastet, me pretendimet si më sipër, punonjësit kërkojnë rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, ku ata kanë emërimin e përhershëm.

Gjatë procesit të hetimit administrativ të rasteve të mësipërme, u konstatua që tashmë, nga ana e institucionit, është vepruar duke i kthyer këta punonjës në vendet e tyre të mëparshme të punës. Konkretisht, me aktin nr. 12005, datë 5.7.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësi doganor *****, është kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, “*Specialist, Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Regjimeve Doganore*”, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë DPD, ndërsa nëpunësi doganor *****, me aktin nr.13043, datë 16.7.2021, është rikthyer në pozicionin “*Doganier, Terminali i Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenjerët*”, Dega Doganore Durrës.

Në këto kushte, kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka reaguar, duke i kthyer këta punonjës në pozicionin e mëparshëm të punës, ku ata kanë marrë emërimin e përhershëm pas ristrukturimit të institucionit, Komisioneri vlerëson të mos shprehet për problemin e ligjshmërisë së proceseve të transferimit të përkohshëm, pasi veprimet e mësipërme administrative, pavarësisht kufizimeve që përmban legjislacioni i shërbimit civil, janë të lejueshme nga legjislacioni i posaçëm doganor.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të Kodit Doganor, në shkronjën “a” parashikon: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Pra, siç shihet, në përmbajtjen e germës “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, është evituar kufizimi i dispozitës së

ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës lejohej të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (njëherësh ose e copëzuar) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Kjo, në kuptimin literal të dispozitës së Kodit Doganor, do të thotë që, një nëpunës doganor, nuk ka pengesë të shprehur, që të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme, pa patur ndonjë kufizim ligjor në shpeshhtësi.

Megjithatë, mënyra si është vepruar në këto raste, tregon se është tepruar me këtë mundësi që ka lejuar legjislacioni doganor. Në rastet e mësipërme, në kundërshtim me përcaktimet e neneve 99, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, dhe parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, mosdiskriminimit, etj., të të drejtës administrative, në aktet e transferimit të përkohshëm, është përcaktuar vetëm data e hyrjes në fuqi të aktit, por nuk është caktuar data e përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm.

Për të argumentuar ligjshmërinë e këtij veprimi, nga ana e institucionit arsyetohet që, përderisa afati maksimal i transferimit të përkohshëm është 6 muaj, nënkuptohet që dita e fundit e afatit 6 mujor është dita e mbarimit të fuqisë së aktit përkatës. Ky arsyetim nuk mund të pranohet, pasi vjen në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitës së pikës 7/i, të nenit 15, të Kodit Doganor, e cila shprehet se transferimi në interes të institucionit, mund të bëhet për një afat deri në 6 muaj, gjë e cila do të thotë se nuk është e thënë që transferimi i përkohshëm, duhet të zgjasë patjetër për një afat 6 muaj, por mund të jetë edhe më pak. Mospërcaktimi i afatit të mbarimit në çdo rast të transferimit të përkohshëm, vjen në kundërshtim me parimin e qëndrueshmërisë në detyrë të nëpunësit civil e për më tepër, lejon që në shumë raste ai të tejkalohet pa pëlqimin e nëpunësit, duke vënë në rrezik edhe ndryshimin e kërkesave të marrëdhënies në shërbimin civil, për të cilën është lidhur kjo marrëdhënie juridike e natyrës administrative.

Në kushtet kur në rastet e dy nëpunësve ***** dhe ***** , është vepruar pozitivisht nga ana e institucionit, duke i kthyer në vendet e tyre të punës, shkeljet e përmendura më sipër, të lejuara në kryerjen e transferimeve të përkohëshme, evidentohen në mënyrë që të mos përsëriten në të ardhmen.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenin 14, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16, pika 6, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesave me nr.672 prot., datë 16.6.2021, të nëpunësit ***** dhe me nr.691 prot., datë 30.6.2021, të nëpunësit *****, në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të përkohshëm dhe arkivimin e çështjeve, duke i vënë në dukje institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, që në të ardhmen të tregojë kujdes për plotësimin e gjithë kërkesave të legjislacionit administrativ, në përpilimin dhe formulimin e akteve të transferimit të përkohshëm, siç është përmendur në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësit ***** dhe *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha